

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, nga Gjyqtari Ahmet Idrizaj, me pjesëmarrjen e Sekretares juridike Samile Pasha, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit Gj. (M.) B., nga fshati B., Komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson i autorizuari P. P., avokat nga Gjakova, kundër të paditurëve J. S., F. S., F. S., F. S. dhe C. S., që të gjithë nga Deçani, pa nr. të cilët i përfaqëson i autorizuari J. L., avokat në Deçan, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, në shqyrtimin e mbajtur me dt.12.04.2017, me propozimin e të autorizuarve të palëve në procedurë, mori këte:

AKTGJYKIM NË BAZË TË POHIMIT

MIRATOHET kërkesë-padia e precizuar e paditësit Gj. (M.) B., nga fshati B., Komuna e Gjakovës, ashtu që **VËRTETOHET** se i njëjti është pronar i paluajtëshmërisë të evidencuar si njësi kadastrale P-70705063-0026408 ZK Radoniq, lloji i njësishë parcelë, tipi i pronës pronë private, vendi i quajtur “Rrafshina”, në sipërfaqe prej 21472 m², shfrytëzimi aktual pyjor i klasës 3, pjesë e pronës 1/1, sipas Certifikatës nr.807-17, i 1/3 pjesë ideale të njësishë kadastrale P70705032-00001-4 ZK Zhdrellë, lloji i njësishë – parcelë, tipi i pronës – pronë private, vendi i quajtur “Suka”, në sipërfaqe prej 14986 m², shfrytëzimi aktual pyjor – mal i klasës 3, dhe i 1/3 pjesës ideale të njësishë kadastrale P-70705032-00007-3 ZK Zhdrellë, lloji i njësishë – parcelë, tipi i pronës – pronë private, vendi i quajtur “Suka”, në sipërfaqe prej 4423 m², shfrytëzimi aktual – pyjor – mal i klasës 3, sipas Certifikatës 807/17, dhe detyrohen të paditurit J. S., F. S., F. S., F. S., Sh. S. dhe C. S., që të gjithë nga Deçani, që paditësit t’ia njohin këtë të drejtë, në afatin prej 15 ditëve, e nën kërcenim të përmbarimit.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedura.

A r s y e t i m

Të paditurit në përgjigje në padi të parashtruar me dt.22.09.2014 dhe në shqyrtimin e dt.13.04.2017, nëpërmes të autorizuarit të tyre kanë parashtruar se e pranojnë në tërësi kërkesë-padinë e precizuar të paditësit.

Andaj Gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm (dhe duke pasur parasysh faktin se kërkesat e palëve në procedurë nuk bien ndesh me nenin 3 parag.3 të LPK) me pajtimin e plotë të palëve në procedurë dhe në mbështetje të nenit 148.1 lidhur me nenin 160.6 të Ligjit për procedurën kontestimore nr.38/2008, i shpallur në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës” me dt.20.09.2008 vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 450 të LPK, dhe deklarimit të palëve prezente në procedurë.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.378/14, me dt.12.04.2017.

GJYQTARI,
Ahmet Idrizaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar Ankesa, në afatin prej 15 ditëve, nga dita marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate, vetëm për arsytet e parapara në nenin 181.2 të LPK.

